



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Në mbështetje të nenit 57 paragrafi 1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, Oda e Stomatologëve të Kosovës shpall këtë:

Konkurs Publik

Emri i Institucionit:	Oda e Stomatologëve të Kosovës
Departamenti	Shërbimi Profesional i OSK-së
Titulli i punës:	Sekretar i Përgjithshëm
Numri i zyrarëve:	1 (një) pozitë
Raporton te:	Kryetari i OSK-së
Lloji i kontratës:	Periudhë e pacaktuar – periudha provuese 3 mujore
Orët e punës në javë:	40

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon dhe menaxhon punën e shërbimit profesional të OSK-së;
- Ndihmon Kryetarin e Odës dhe merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e seancave të Kuvendit, Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikqyrës dhe organeve tjera të OSK-së;
- Siguron që vendimet dhe masat tjera të organeve të OSK-së të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive;
- Përfaqëson OSK-në në marrëdhëniet juridike në pajtim me ligjin;
- Është përgjegjës për zbatimin e planit financiar;
- Kryen detyra të cilat lidhen me zbatimin e Statutit, rregulloret, vendimet, konkluzionet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi dhe organet e OSK-së;
- Është përgjegjës për arkivimin e rregulloreve, vendimeve dhe akteve tjera të nxjerra nga organet e Odës;
- Menaxhon rrjedhën e informacionit në OSK;
- Bashkëpunon me sekretarët e Odave tjera në baza të rregullta;
- Merr pjesë në mbledhjet e organeve të Odës sipas nevojës dhe kërkesave të organeve përgjegjëse;
- Kryen edhe detyra tjera të përcaktuara nga Kryetari i Odës në pajtim me Statutin dhe aktet tjera juridike të OSK-së;

Aftësitë/ përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen :

- Të ketë kryer Fakultetin Juridik, Ekonomik apo drejtime të përafërta ;
- 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhët zyrtare, konsiderohen përparësi;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access).
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në vendin tonë;
- Shkathësi komunikuese dhe planifikim të punës si dhe të ketë aftësi në formulim të akteve ligjore, rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Të jetë i përkushtuar, me iniciativë, aftësi dhe vullnet për të marr përgjegjësi

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurimit:

Procedura e konkurimit është publike dhe hapur.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja e aplikacionit: Zyra administrative e OSK-së, Ulpianë Rr. Mark Dizdari, D7 Hyrja II nr.6 ose shkarkimi i aplikacionit nga wefaqja zyrtare.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbdhjetë) ditë kalendarike, nga data 04.08.2022 deri më 18.08.2022, ora 15.00.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin dhe dokumente tjera të nevojshme që kërkohen vendi i punës dhe dorëzohen në zarf të mbyllur (jo përmes postës elektronike) në zyrën Administrative të OSK-së, Ulpianë Rr. Mark Dizdari, D7 Hyrja II nr.6.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh!.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në numër telefoni 045 240-588, prej orës 9:00 – 15:00 ose email adresën odastomatologjike@gmail.com